

Nr. Prot. 009/B/20**VENDIMI Nr. 1496****Për****‘Caktimin e blloqeve numerike Jo-Gjeografike (mobil) nga seritë****(0)43 xxx xxx dhe (0)49 xxx xxx****për përdorim nga Operatori “IPKO Telecommunications” LLC**

Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 3), nenit 58, nenit 59, paragrafi 1) dhe neni 79, paragrafi 1) dhe 2) i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*); nenit 4 paragrafi 2.a) dhe paragrafi 4.5), nenit 5), neni 6) paragrafi 7), nenit 8) dhe nenin 16) të Rregullores Nr. 32 për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës (*Ref. Nr. Prot. 038/B/17, tutje referuar si - Plani i Numeracionit*); në bazë të kërkesës së operatorit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, IPKO Telecommunications LLC (*tutje referuar si - IPKO*) të datës: 21/01/2020 (*Ref.Nr.Prot.022/2/20*) dhe nenit 11 paragrafi 3.3) dhe paragrafi 3.18) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - ARKEP ose Autoriteti*), Bordi i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Bahri Anadolli Anëtar
- 2) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 3) z. Nijazi Ademaj Anëtar, dhe
- 4) z. Shqiprim Pula Anëtar,

në mbledhjen e 52-të me radhë të mbajtur më datë 31 Janar 2020, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, rekomandimit të paraqitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamentit Ligjor (DL), vendosi si më poshtë:

VENDIM

- I. Aprovohet kërkesa e operatorit **IPKO** për caktimin e blloqeve numerike jo-gjeografike mobile të specifikuara si më poshtë:

Prefiksi (NDC)	Fillimi i Bllokut	Fundi i Bllokut	Madhësia e Bllokut
(0)43	100 000	109 999	10,000
(0)49	070 000	079 999	10,000
Gjithsej;			20,000

- II. Bllloqet numerike të caktuara në pikën I) të këtij vendimi do të shfrytëzohen për nevoja dhe ofrim të shërbimeve të telefonisë mobile në afat të pa caktuar.
- III. Tarifimi për bllloqet numerike të caktuara në pikën I) të këtij vendimi do të bëhet në bazë të nenit 8 të Planit të Numeracionit.
- IV. Pagesa vjetore për numeracionin e caktuar në pikën I) të këtij vendimi do të bëhet brenda periudhës prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal.
- V. Nëse **IPKO** dëshiron të kthejë numrat e caktuar në pikën I) të këtij vendimi pas një periudhe të shfrytëzimit të tyre, atëherë i njëjti obligohet që të paraqesë kërkesën pranë ARKEP për mosshfrytëzim të tyre.
- VI. ARKEP rezervon të drejtën që në të ardhmen të ndryshojë këtë vendim, nëse e sheh të arsyeshme, konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe për çdo ndryshim në lidhje me vendimin, me kohë do të informojë palët e interesit.
- VII. Shfuqizohet Vendimi nr.1231 (Ref. Nr.Prot.040/B/18) për 'Rezervimin e bllloqeve numerike Jo-Gjeografike (mobil) nga seritë (0)43 xxx xxx dhe (0)49 xxx xxx për përdorim nga Operatori "IPKO Telecommunications LLC".
- VIII. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 59, paragrafi 1) përkufizon se numrat, seritë numerike, mund të përdoren vetëm në bazë të vendimit të Autoritetit. Rrjedhimisht asnjë ndërmarrës i përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, operator dhe/apo ofrues i shërbimit universal, ose shfrytëzues tjerë nuk mund të përdorë një numër-at apo bllloqet/seritë numerike përveç nëse dhe derisa ARKEP t'i caktojë (akordojë) apo vazhdojë autorizimin për përdorimin e numrave të tillë.

Në bazë të Planit të Numeracionit, nenit 16, seria 4x e numrave është e përcaktuar si seri e numeracionit jo-gjeografik **për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile**.

ARKEP me vendimin nr.1231 (Ref. Nr.Prot.040/B/18) i ka rezervuar operatorit IPKO bllloqet numerike **043**: 100 000 – 199 999 dhe **049**: 000 000 – 099 999 deri më datë 04/07/2020.

Neni 6, paragrafi 7) i Planit të Numeracionit specifikon se rezervimi mund të ndërprehet nga aplikuesi përmes një kërkesë me shkrim, të dorëzuar në zyrën e ARKEP ose nga vet ARKEP-i nëse konsiderohet e nevojshme.

Më datë 21 Janar 2020, IPKO ka parashtruar kërkesë në ARKEP (Ref. Nr.Prot.022/2/20) për anulimin e rezervimit dhe caktimin e serive numerike; **043**: 100 000 – 109 999 dhe **049**: 070 000 – 079 999.

Neni 5, paragrafi 4) i Planit të Numeracionit përcakton se periudha kohore e caktimit të resurseve numerike për ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike është e pakufizuar, përveç nëse nuk është specifikuar ndryshe me vendim të Autoritetit. Po ashtu neni 8, paragrafi 1) i Planit të Numeracionit përcakton se për numrat jo-geografik mobil (Seria 4x), tarifa është 0.06 euro për numër për vit.

Andaj, me qëllim të;

- Sigurimit të strukturimit dhe shfrytëzimit efikas të numrave dhe serive të numrave;
- Përbushjes së nevojave të arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave;
- Sigurimin që caktimi dhe përdorimi i numrave/serive numerike bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe jo-diskriminuese; dhe
- Zhvillimit adekuat të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Atëherë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 10/ 02/ 2020

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Aktvendimi i dërgohet;

- IPKO Telecommunications LLC.
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP
- Departamentit Ligjor, ARKEP dhe
- Arkivit